



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK
KRYETARI

Nr. 1236 Prot

Shijak, më 24.02.2021

VENDIM

Nr. 85, datë 24.02.2021

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË DETYRUAR VENDOR, TË NDRYSHUAR, PËR
ZONËN E RE PËR ZHVILLIM, ZONA 1 NË NJËSINË ADMINISTRATIVE SHIJAK,
BASHKIA SHIJAK”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, neni 9, pika 1/1, shkronja”b” dhe nenit 23, pika 14 e Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr. 97/2019 “Për miratimin e Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, nenit 13 dhe 25 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 887, datë 24.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurës së përsheptuar për hartimin dhe miratimin e Planit të Detyruar Vendor, si dhe procedurës së miratimit të Lejeve të Zhvillimit/ Ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore, Vendimit Nr. 45, datë 22.01.2020 “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në njësinë administrative Shijak, Bashkia Shijak dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese”, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.108, datë 07.12.2020 “Për miratimin e planit të detyruar vendor, të ndryshuar, për Zonën e re për zhvillim, Zona 1, Njësia Administrative Shijak, Bashkia Shijak”, Konfirmimit të Prefektit të Qarkut Durrës, Nr.1083/5, datë 15.12.2020, “Për verifikimin e ligjshmërisë së aktit”,

VENDOSA:


1. Miratimin e Planit të Detyruar Vendor, të ndryshuar për Zonën e Re për Zhvillim, Zona 1 Njësia Administrative Shijak, në funksion të procesit të rindërtimit, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në aktet normative në fuqi, si më poshtë vijon:

Pdyv-ja e ndryshuar përfshin ndërtimin e 31 pallateve 7 dhe 8 kat, ku përfshihet rindërtimi i 78.680 m2 ndërtim, të ndara përkatësisht si më poshtë:

- 95 apartamente 1+1
- 303 apartamente 2+1

- 258 apartamente 3+1
 - sipërfaqe shërbimi 9975 m2
 - sipërfaqe garazh nëntokësore 3275 m2
 - sipërfaqe të gjelbërta 8520 m2
 - vendparkime të hapura 146 m2
2. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për botimin e Vendimit dhe dokumentat shoqërues të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e miratimit të tij, sipas ndryshimeve të miratuara.
3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi pas botimit në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

Konceptoi: Juriste A. Beqiri
Drejtori DPZHT J. Goga

KRYETARI

Elton Arbana

